



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29.07.2024

Nr: 145

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E KURRIKULËS SË TRAJNIMIT QË DO TË PËRDORET PËR
TRAJNIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT,
KZAZ NR. 88, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË
HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa “b” dhe “n” dhe pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S I :

1. Miratimin e kurrikulës së trajnimit që do të përdoret për trajnimin e anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit, KZAZ nr. 88, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtorja e Administratës Zgjedhore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 29.07.2024 Nr:145
Ora: 12:00



Për miratimin e kurrikulës së trajnimit që do të përdoret për trajnimin e anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit, KZAZ nr. 88, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE
Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajnimeve

KURRIKULA E TRAJNIMIT

“PËR ANËTARËT E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT”



ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË,
4 GUSHT 2024





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

DREJTORIA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE
Sektori i Dokumentacionit Zgjedhor dhe Trajnimeve

KURRIKULA E TRAJNIMIT

“PËR ANËTARËT E KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT”

ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË, 4 GUSHT 2024

I. TË PËRGJITHËSHME

Emërtimi i kurrikulës së trajnimit	Trajnim i KQV
Target grupi që trajnohet	Anëtarët dhe sekretari i KQV
Numri i pjesëmarrësve që do të trajnohen	260
Lloji i trajnimit	I drejtpërdrejtë
Kohëzgjatja e trajnimit	3 Orë
Struktura propozuese	Drejtorja e Administratës Zgjedhore
Periudha e trajnimit	29 korrik-3 gusht 2024
Vendi i zhvillimit të trajnimit	ambiente publike
Struktura që zhvillon trajnimin	Drejtorja e Administratës Zgjedhore



II. TË DHËNA MBI KURRIKULËN

1. OBJEKTIVAT	3
2. PROFILI I ANËTARËVE TË TARGET GRUPIT QË TRAJNOHET.....	3
3. TEMAT PËR TRAJNIM	3
3.1 Përbërja e KQV.....	3
3.2 Rregullat e etikës	3
3.3 Shkarkimi, lirimi dhe dorëheqja në KQV	3
3.4 Vakancat në KQV.....	3
3.5 Detyrat e KQV	3
3.6 Mbledhjet dhe vendimet e KQV	3
3.7 Dokumentacioni dhe vulat e KQV	4
3.8 Mjetet e komunikimit me KQZ-në	4
1. Aplikacioni KQZ, përdorimi dhe raportimi.....	4
2. Ndërplatformat Whatsapp dhe Telegram	4
3. Komunikimi me telefon	5
3.9 Veprimtaria e KQV një ditë para zgjedhjeve.....	5
3.10 Veprimtaria e KQV në ditën e votimit	7
1. Veprimet paraprake	7
2. Veprimet paraprake të KQV për hapjen e votimit.....	7
4. Procedura e votimit.....	8
5. Veprimet e KQV kur PEI nuk punon.....	9
6. Mbyllja e votimit.....	9
7. Veprimet pas mbylljes së votimit	9
3.12 Raste të veçanta të votimit.....	10
3.13 Veprimet që cenojnë procesin e votimit	11
4. MATJA E REZULTATEVE TË TRAJNIMIT.....	11



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

1. OBJEKTIVAT

Njohja e anëtarëve të KQV me detyrat para, gjatë dhe pas votimit.

2. PROFILI I ANËTARËVE TË TARGET GRUPIT QË TRAJNOHET

Anëtarët e KQV duhet të gëzojnë të drejtën për të qenë zgjedhës e të jenë me vendbanim në zonën përkatëse zgjedhore si dhe të kenë të paktën arsimin e mesëm. Sekretari i KQV duhet të jetë me profesion jurist.

3. TEMAT PËR TRAJNIM

3.1 Përbërja e KQV

KQV është Komisioni i Qendrës së Votimit, i cili përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në Qendrën e Votimit (QV). KQV përbëhet nga 7 anëtarë ku njëri prej tyre ushtron detyrën e sekretarit. Përbërja e KQV orientohet nga respektimi i balancës politike. Për më shumë mbi përbërjen e KQV, referojuni shtojcës 1, bashkëlidhur këtij materiali, në rubrikën “1. Përbërja e KQV”.

3.2 Rregullat e etikës

KQV, gjatë kryerjes së detyrave zbaton parimet e ligjshmërisë, kolegjalitetit, profesionalizmit, pavarësisë, paanësisë, objektivitetit, përgjegjësisë dhe transparencës.

Rregullat e etikës i gjeni në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij materiali në rubrikën “2. Rregullat e etikës”.

3.3 Shkarkimi, lirimi dhe dorëheqja në KQV

Anëtari apo sekretari i KQV shkarkohet apo lirohet nga detyra me vendimi të KZAZ. Shkarkimi, lirimi dhe dorëheqja trajtohet në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij materiali në rubrikën “3. Shkarkimi, lirimi dhe dorëheqja në KQV”.

3.4 Vakancat në KQV

Shkarkimi, lirimi apo dorëheqja nga detyra e anëtarit të KQV apo mungesa e tij, bën që KQV të ndodhet në kushtet e vakancës. Për krijimin e vakancave në KQV në ditën e zgjedhjeve referojuni shtojcës 1, rubrikës “4. Vakancat në KQV”

3.5 Detyrat e KQV

Kryetari i KQV drejton veprimtarinë e KQV që nga dita e ngritjes së saj, ndërsa detyra e sekretarit të KQV lidhet me administrimin e gjithë dokumentacionit ligjor ku bazohet puna e KQV. Anëtari i KQV zbaton detyrat e përcaktuara me Vendim të KQV në funksion të mbarëvajtjes së zgjedhjeve në QV.

Detyrat e kryetarit, sekretarit dhe anëtarëve të KQV i gjeni të trajtuara në shtojcën 1 në rubrikën “5. Detyrat e KQV”.

3.6 Mbledhjet dhe vendimet e KQV

KQV merr vendime në mbledhjet e organizuara prej saj. Në shtojcën 1, në rubrikën “Mbledhjet dhe vendimet e KQV”, do të gjeni informacion mbi mbledhje, vendimet dhe vlefshmërinë e tyre.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

3.7 Dokumentacioni dhe vulat e KQV

Në dokumentacionin e punës të KQV-së përfshihen modelet e vendimeve apo procesverbaleve të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Dokumentacioni i punës së KQV administrohet nga sekretari i KQV.

Dokumentacioni dhe vulat e KQV i gjeni në shtojcën 1, në rubrikën “6 Dokumentacioni dhe vulat e KQV”.

3.8 Mjetet e komunikimit me KQZ-në

KQZ vendos në ndihmë të KQV këto mjete komunikimi:

1. Aplikacionin KQZ i shkarkueshëm në aparatët telefonikë me system operativ Android ose IOS
2. Komunikimi me Telegram dhe Whatsapp në numrin e telefonit 0694003032

1. Aplikacioni KQZ, përdorimi dhe raportimi

Aplikacioni ofron mundësinë që çdo anëtar, apo sekretar i KQV të informojë dhe të raportojë individualisht dhe i pa kushtëzuar nga anëtarët e tjerë të komisionit përkatës

Çdo anëtar i KQV përfshirë edhe sekretarin shkarkon aplikacionin KQZ dhe ndjek këto hapa:

- a. Krijon llogarinë në këtë aplikacion. Veprimet për krijimin e llogarisë, i gjeni bashkëlidhur këtij materiali në shtojcën 2, në rubrikën “A. Krijimi i llogarisë. Aplikacionin KQZ” .
- b. Hyn në llogari sipas orientimeve të cilat i gjeni në shtojcën 2, në rubrikën “B. Hyrja në llogari”
- c. Plotëson fushat përkatëse që ju shfaqen në aplikacion vetëm duke klikuar mbi to.

2. Ndërplatformat Whatsapp dhe Telegram

KQZ për t’ju ardhur në ndihmë anëtarëve të KQV-së vendos në dispozicion numrin e celularit **0694003072** për të komunikuar në platformat Whatsapp dhe Telegram.

Çdo anëtar i KQV-së ftohet me lidhjen përkatëse që të bëhet pjesë e grupit. Për t’u bërë pjesë e grupit anëtari i KQV-së skanon nga aparati i tij telefonik kodin QR në Whatsapp dhe Telegram si më poshtë:



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

Zgjedhje Himare 4.8.2024

WhatsApp group



Telegram 1



Whatsapp 1

Këto mjete komunikimi shërbejnë për të marrë udhëzime & informacione në kohë reale nga KQZ.

3. Komunikimi me telefon

Çdo anëtar i KQV-së apo subjekt i interesuar mund të telefonojë në numrin 0694003072.

3.9 Veprimtaria e KQV një ditë para zgjedhjeve

1. Kryetari dhe sekretari i KQV (dhe nëse dëshiron edhe çdo anëtar tjetër) paraqiten në KZAZ, një ditë para zgjedhjeve jo më vonë se ora 15.00.
2. Marrin në dorëzim nga KZAZ:
 - a. Kutinë me materialet e votimit. Në këtë kuti gjenden:
 - i. fletët e votimit,
 - ii. vula e KQV,
 - iii. libri i protokollit të mbledhjeve
 - iv. regjistri i posaçëm i zgjedhësve
 - v. zarfi përkatës për fletët e votimit, të dëmtuara,
 - vi. zarfi përkatës për fletët e votimit, të papërdorura,
 - vii. procesverbalin e vulosjes
 - viii. procesverbalin e mbylljes së votimit
 - ix. zarfi i vërtetimeve të identifikimit elektronik të zgjedhësve.
 - x. Lënda e posaçme për timbrimin e zgjedhësve.
 - b. Kutinë e votimit;
 - c. Vulat me kodet e sigurisë;
 - d. Listën e zgjedhësve. Lista e zgjedhësve përdoret vetëm në rastet kur PEI nuk funksionon.
 - e. Pajisjen elektronike të identifikimit PEI



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

- f. Kamerën e vëzhgimit. Sigurohen që numri i QV-së në kamera korrespondon me KQV që merr në dorëzim kamerën.
- g. Dhomat e fshehta.
- h. Vulën e kryetarit të KQV.
- i. Paketën me mjete kancelarie, postera e materiale informuese për procesin e votimit.
3. Verifikojnë sasinë e materialeve të marra në dorëzim, me të dhënat e plotësuara në procesverbalin KZAZ-KQV, model KQZ-00-05, nga anëtari/ sekretari i KZAZ-së.
4. Nënshkruajnë procesverbalin model KQZ-00-05.
5. Kryetari dhe sekretari i KQV-së, verifikojnë:
 - a. 5 vula metalike me kode sigurie me të njëjtën ngjyrë do të shërbejnë për mbylljen e kutisë së votimit;
 - b. 3 vula metalike me ngjyrë tjetër të cilat përdoren vetëm në rast dëmtimi të kodeve me vula sigurie;
 - c. 4 vula metalike me kode sigurie për mbylljen e kutisë së materialeve të votimit.
6. Nënshkruajnë procesverbalin model KQZ-00-06 “Për pajisjen e KQV nga KZAZ me vula me kode të sigurisë”.
7. Kryetari dhe sekretari i KQV marrin secili nga një kopje të procesverbalit KQZ-00-05 dhe KQZ-00-06.
8. Kryetari merr në dorëzim vulën e kryetarit të KQV duke vepruar si vijon:
 - a. merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara;
 - b. gris ambalazhin e vulës;
 - c. në një letër të bardhë vulos modelin e krahasimit të vulës;
 - d. poshtë secilës vulë shënon me shkrim dore emrin dhe mbiemrin e tij dhe nënshkruan në prani të anëtarëve të KZAZ-së.
 - e. Letra e bardhë me modelin krahasues të secilës vulë, nënshkruhet në pjesën e pasme të saj nga anëtarët e KZAZ-së dhe mbahet në ruajtje nga sekretari i KZAZ-s
 - f. Kryetari merr në dorëzim vulën e kryetarit të QV duke depozituar specimenin e firmës së tij e cila ruhet në KZAZ.
9. Kryetari dhe sekretari i KQV nisen për në qendrën e votimit, së bashku me materialet e marra në dorëzim.
10. Verifikojnë ambientin e votimit dhe sigurinë e tij.
11. Sigurohen që punonjësi i policisë është prezent pranë ambientit të votimit.
12. Mbyllin derën me etiketa sigurie dhe çdo akses tjetër për në qendrën e votimit
13. Plotësojnë procesverbalin KQZ-00-11 “Procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit një ditë para ditës së zgjedhjeve me etiketën e sigurisë” me punonjësin e policisë për mbylljen e ambientit të qendrës së votimit.
14. Nënshkruajnë procesverbalin dhe marrin secili nga një kopje të këtij procesverbali.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

3.10 Veprimtaria e KQV në ditën e votimit

1. Veprimet paraprake

- b. Kryetari, sekretari, anëtarët e KQV dhe operatori paraqitet në QV në orën 6.00 të mëngjesit.
- c. Marrin në dorëzim QV nga policia e shtetit.
- d. Nënshkruajnë procesverbalin e marrjes në dorëzim të QV nga policia e shtetit.
- e. Operatori vendos në funksion kamerën e vëzhgimit në mënyrë që të shihet e gjithë veprimtaria në KQV duke mos cenuar fshehtësinë votës. Procesi i regjistrimit fillon që në orën 6.00 dhe vijon pandërprerë derisa KQV me kutitë e votimit dhe atë të materialeve zgjedhore largohen nga qendra e votimit.
- f. KQV organizon qendrën e votimit (tryeza, karrige, dhomat e fshehta, vendin e vëzhguesve, afishimin e materialeve propagandistike që kanë marrë nga KZAZ, flamurin kombëtar, tabelën treguese për numrin e KZAZ, numrin e QV dhe orarin e votimit).
- g. heq materialet propagandistike që mund të ndodhen në QV ose rreth saj në një rreze prej 150 m;
- h. afishon udhëzimet për kryerjen e votimit në një vend të dukshëm brenda qendrës së votimit;
- i. I dorëzon operatorit pajisjen PEI. Ky veprim dokumentohet me plotësimin e procesverbalit KQZ-00-10 KQV-Operator “Për dorëzimin e pajisjes PEI”.
- j. Operatori i pajisur me badge (dokument identifikues) dhe jelek, vë në funksion pajisjen elektronike të identifikimit PEI. Operatori ulet ndërmjet kryetarit dhe sekretarit të KQV. Pajisja përdoret vetëm nga operatori. Në asnjë rast anëtarët e KQV-se nuk përdorin pajisjen.

2. Veprimet paraprake të KQV për hapjen e votimit

- a. Sekretari kontrollon/ inventarizon të gjitha materialet zgjedhore sipas procesverbaleve të cilat i disponojnë nga KZAZ .
- b. KQV merr vendim për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV-së, sipas modelit të vendimit “Për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV”, miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
- c. U tregon vëzhguesve kutinë e votimit, të zbrazët.
- d. Vulos kutitë e votimit me katër vula me kode sigurie në mënyrë të tillë, që të mos lejojë hapësira mes kutive dhe kapakut të tyre, dhe plotëson modelin e procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit. Në rast se ndonjë nga vulat me kodet e sigurisë dëmtohet gjatë mbylljes së kutisë së votimit, ajo zëvendësohet me një nga vulat rezervë. Në librin e protokollit dhe në procesverbalin e vulosjes shënohet numri i kodit të sigurisë së dëmtuar dhe ai i vulës shtesë.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

- e. Konfirmon, pas aktivizimit të pajisjes PEI nga operatori teknik, numrin e qendrës së votimit, vendodhjen e saj si dhe numrin e zgjedhësve në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit.
- f. Verifikon nëse informacioni që shfaqet në ekranin e pajisjes PEI është i njëjtë me të dhënat e QV. Nëse këto të dhëna janë të njëjta, autorizon operatorin të vijojë konfigurimin e pajisjes PEI.
- g. Pajisja PEI printon raportin e hapjes të procesit të identifikimit elektronik, ku numri i zgjedhësve identifikuar elektronikisht duhet të jetë 0. Ky raport nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së dhe vuloset me vulën e KQV-së. Raporti i hapjes së procesit të identifikimit elektronik futet në kutinë e materialeve të votimit.
- h. Sekretari fut në kutinë e votimit, para fillimit të procesit të votimit, zarfin e etiketuar “Zarfi i procesverbalit të vulosjes”, në të cilin futet origjinali i procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KQV-së, të vulosur nga sekretari dhe mbyllur prej tij. Një kopje e këtij procesverbali, pasi është mbyllur në zarfin “Zarfi i procesverbalit të vulosjes” futet në kutinë e materialeve të votimit.
- i. Marrin vendimin për hapjen e votimit, sipas modelit të vendimit KQZ-01-25 “Për hapjen e votimit”.
- j. Përmes kryetarit, deklarojnë hapjen e votimit jo më parë se ora 7.00.

4. Procedura e votimit

1. Zgjedhësi paraqitet para KQV dhe i paraqet dokumentin e identifikimit kryetarit të KQV.
2. Kryetari i KQV kryen verifikimin fizik të mbajtësit të dokumentit dhe fotos në dokumentin e ID.
3. Kryetari i KQV i jep operatorit PEI, dokumentin e identifikimit të zgjedhësit.
4. Operatori shfaq të dhënat e zgjedhësit në ekran, përfshirë dhe foto.
5. Anëtarët e KQV verifikojnë në ekranin e pajisjes të dhënat e zgjedhësit, përfshirë edhe foton.
6. Operatori fton zgjedhësin, që është në listën e zgjedhësve të asaj qendre votimi, të nënshkruajë biometrikisht në pajisje.
7. Operatori, i jep kryetarit të KQV dokumentin që printohet nga pajisja.
8. Kryetari i KQV, dokumentin e printuar që përbën material zgjedhor e fut në një zarf te posaçëm.
9. Në asnjë rast anëtarët e KQV-se nuk duhet të ndajnë me persona të tjerë të pranishëm në QV (vëzhgues) numrin rendor të tij.
10. Secili nga anëtarët e KQV kryen detyrën që i është caktuar në momentin e ndarjeve të detyrave.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

5. Veprimet e KQV kur PEI nuk punon

Kur PEI nuk punon ndiqen këto hapa:

- a. Njoftohet KQZ
- b. Pritet 3 orë që pajisja të zëvendësohet apo riparohet.
- c. Kur pajisja nuk riparohet brenda këtij afati, KQV merr vendimin për të kaluar tek identifikimi tradicional i zgjedhësve me listë të printuar zgjedhësish. Çdo vendim i marrë nga KQV, pa kaluar ky afat ose pa pasur një vendimmarrje nga KQZ për kalimin e identifikimit të zgjedhësve me listë fizike zgjedhësish, është i paligjshëm.

6. Mbyllja e votimit

1. Votimi mbyllet në orën 19.00. Pas kësaj ore, një nga anëtarët e KQV mbledh dokumentet e identifikimit të zgjedhësve që janë në radhë për të votuar.
2. Anëtari i KQV i thërret me radhë ata për të kryer votimin. Votimi mbyllet pasi voton edhe zgjedhësi i fundit, i pranishëm.
3. Votojnë të fundit: Anëtarët e KQV-së; Operatori teknik i QV-së/personi i ngarkuar për funksionimin e kamerës, nëse nuk është zgjedhës në atë qendër votimit dhe është zgjedhës i zonës zgjedhore.
4. KQV-ja merr vendim për mbylljen e votimit.
5. Operatori teknik mbyll procesin e identifikimit elektronik të zgjedhësve.
6. PEI printon raportin e mbylljes, i cili nënshkruhet nga anëtarët e KQV-së.
7. Sekretari i KQV vulos raportin e mbylljes PEI.
8. Kryetari administron raportin e mbylljes PEI.
9. Operatori mbyll pajisjen PEI mbyllet në valixhe me vulë me kod sigurie.
10. Sekretari plotëson procesverbalin KQV-Operator “Për dorëzimin e pajisjes PEI”.
11. Kryetari deklaron me zë të lartë të dhënat për zgjedhësit që kanë votuar, dhe urdhëron sekretarin të plotësojë, në të gjitha rubrikat, procesverbalin për mbylljen e votimit.

7. Veprimet pas mbylljes së votimit

1. Kryetari nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së fillon numërimin e fletëve të votimit të papërdorura dhe deklaron shifrën. Nëse kërkohet rinumërimi nga ndonjë anëtar i KQV apo vëzhgues, ai rifillon sërish. Ky numër pasqyrohet në procesverbalin e mbylljes së votimit, në librin e protokollit të mbledhjeve dhe këto fletë votimi futen në zarfin e fletëve të votimit të papërdorura.
2. Kryetari, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së apo edhe vëzhguesve, fillon numërimin e fletëve të votimit të dëmtuara dhe shifra pasqyrohet në procesverbalin për



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

mbylljen e votimit, në librin e protokollit të mbledhjeve dhe këto fletë votimi futen në zarfin e fletëve të votimit të dëmtuara. Nëse ka vërejtje, ato shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve.

3. I gjithë materiali zgjedhor futen në kutinë e materialeve zgjedhore.
4. Numri i kodeve të sigurisë, me të cilët do të mbyllet kutia e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, shënohen paraprakisht në “Procesverbalin për Mbylljen e Votimit dhe në “Librin e Protokollit të Mbledhjeve” të KQV-së.
5. Originali i “Procesverbalit për Mbylljen e Votimit” futet në kutinë e votimit, e cila vulozet menjëherë me kodin e pestë të sigurisë. Kopje të procesverbalit të mbylljes së votimit futet dhe në kutinë e materialeve të votimit.
6. Kopje të Procesverbalit për Mbylljen e Votimit dhe të raportit të mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve të riprintuar pa përfshirë numrin rendor në listë të zgjedhësve, u jepen anëtarëve të KQV-së dhe vëzhguesve të partive parlamentare.
7. Kryetari, sekretari dhe kushdo tjetër anëtar i KQV që dëshiron, të shoqëruar nga punonjësi e policisë dorëzojnë në KZAZ, kutinë e votimit, kutinë e materialeve të votimit dhe PEI, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se tre orë nga mbyllja e votimit në QV.
8. Në rast se PEI nuk ka funksionuar dhe nuk është printuar raport me të dhëna për numrin e zgjedhësve, kryetari i KQV-së, nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të KQV-së: shënon numrin e zgjedhësve që janë identifikuar nga PEI sipas numrit të dokumenteve fizikë të administruara në zarfin “Vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe deklaron shifrën. Kundërshtimet lidhur me shifrën pasqyrohen në vendimin për përcaktimin e numrit të zgjedhësve që kanë votuar dhe në Librin e Protokollit të Mbledhjeve. Çdo veprim që bëhet me PEI evidentohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

Sqarime për plotësimin e procesverbalit të mbylljes i gjeni në shtojcën 3 në rubrikën “1. Plotësimi i procesverbalit të mbylljes së votimit”

3.11 Rregulla në qendrën e votimit

Rregullat në qendrën e votimit i gjeni në shtojcën 3, në rubrikën “2. Rregulla në qendrën e votimit”

3.12 Raste të veçanta të votimit

Rastet e veçanta të votimit në qendrën e votimit i gjeni në shtojcën 3, në rubrikën “3. Raste të veçanta të votimit”. Në të shtjellohen procedurat që ndiqen me zgjedhësin që për arsye fizike nuk mund të votojë vetë, apo të verbrin që mund të votojë vetë apo zgjedhësi që paraqitet me vendim gjykate si dhe raste të tjera kur dokumenti i identiteti nuk lexohet nga pajisja PEI apo kur zgjedhësi nuk pranon të timbrohet me lëndën e posaçme.



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Program i temave të trajnimit “Për anëtarët e KQV-së”

3.13 Veprimet që cenojnë procesin e votimit

Tema trajton votimin e dyfishtë, apo votimi jashtë dhomës së fshehtë , fotografimi i votës, votimi familjar etj.

Për këto çështje, referojuni në shtojcën 3 bashkëlidhur, në rubrikën “4. Veprimet që cenojnë procesin e votimit”.

4. MATJA E REZULTATEVE TË TRAJNIMIT

Vlerësimi do të bëhet nëpërmjet vlerësimit të angazhimit të komisionereve në temat dhe kazuset, trajtimi i problematikave nëpërmjet rasteve ilustruese.

Shtojca 1

I. Përbërja e KQV-së

KQV është Komisioni i Qendrës së Votimit, i cili përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në Qendrën e Votimit (QV) sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ.

Përbërja e KQV orientohet nga respektimi i balancës politike.

Anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit propozohen nga partitë politike dhe emërohen nga KZAZ, vetëm për periudhën e zgjedhjeve. KQV përbëhet nga 7 anëtarë ku njëri prej tyre ushtron detyrën e sekretarit. Anëtarët dhe sekretari i KQV propozohen nga partitë politike jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe emërohen nga KZAZ, jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve. Kryetari dhe sekretari i KQV-së zgjidhen nga KZAZ-ja. Sekretari është i përkatësisë politike të kundërt me kryetarin.

Për t'u emëruar anëtar i KQV duhet që ai të gëzojë të drejtën për të qenë zgjedhës, të jetë me vendbanim në zonën përkatëse zgjedhore, të ketë së paku arsimin e mesëm, përveç sekretarit i cili duhet të jetë si rregull me arsim të lartë. Gjithashtu ai nuk duhet të jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore në proceset e mëparshme zgjedhore.

Anëtari dhe sekretari i KQV-së nuk mund të jetë deputet, kandidat për deputet në Kuvend, kandidat ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore, ushtarak, punonjës i strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror apo anëtar, sekretar i një komisioni tjetër zgjedhor.

II. Rregulla të etikës

Komisioni i Qendrës së Votimit, gjatë kryerjes së detyrave zbaton parimet e ligjshmërisë, kolegjalitetit, profesionalizmit, pavarësisë, paanësisë, objektivitetit, përgjegjësisë dhe transparencës.

Vepriktaria e tij ushtrohet në respekt të interesit publik. Në ushtrimin e detyrës, anëtarët e komisionit të qendrës së votimit, duhet të trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi. Ata nuk duhet të manifestojnë përkatësinë dhe bindjet partiake, nuk duhet të mbajnë simbole apo shenja dalluese të tyre.

III. Shkarkimi, lirimi nga detyra dhe dorëheqja në KQV

1. Shkarkimi në KQV

KZAZ, me vendim mund të shkarkojë anëtarin apo sekretarin e KQV-së. Anëtarët dhe sekretari i KQV shkarkohen nga detyra, kur shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor ose të akteve nënligjore në zbatim të tij apo kur dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Një shkak tjetër i shkarkimit është edhe kur anëtari apo sekretari i KQV nuk paraqiten në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht ose kur nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ. Kur ata shkarkohen, nuk mund të rizgjidhen më në këtë detyrë.

2. Lirimi nga detyra dhe dorëheqja në KQV

Përveç shkarkimit, KZAZ, me vendim, mund të lirojë nga detyra anëtarin apo sekretarin e KQV-së. Anëtarët dhe sekretari i KQV-së mund të lirohen nga detyra, kur kanë marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore apo janë në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë.

Shkak i lirimit nga detyra është edhe kur ata japin dorëheqje apo nuk plotësojnë më kushtet për të qenë zgjedhës. Lirimi nga detyra ndodh edhe kur subjekti zgjedhor që i ka propozuar kërkon zëvendësimin e tyre. Kur anëtari i KQV-së jep dorëheqjen, deklarata e dorëheqjes depozitohet në KQV dhe sekretari njofton menjëherë KZAZ. Anëtari i KQV-së i liruar apo i dorëhequr, nuk largohet nga detyra, pa e dorëzuar atë tek zëvendësuesi i tij.

IV. Vakancat në KQV

Shkarkimi, lirimi apo dorëheqja nga detyra e anëtarit të KQV apo mungesa e tij, bën që KQV të ndodhet në kushtet e vakancës. Në ditën e zgjedhjeve, mungesa e anëtarit/ëve një orë para hapjes së votimit ose largimit gjatë ditës së votimit njoftohet menjëherë në KZAZ nga cilido anëtar i KQV.

Në rast se shkarkohet, lirohet apo dorëhiqet nga detyra sekretari i KQV-ës, procedurat vijohen nga një anëtar i KQV me të njëjtën përkatësi politike.

1. Anëtarët dhe sekretari i KQV shkarkohen nga detyra, me vendim të KZAZ, në rastet kur:
 - a. Shkelin dispozitat e Kodit Zgjedhor ose të akteve nënligjore në zbatim të tij.
 - b. Dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.
 - c. Nuk paraqiten në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme për më shumë se 2 ditë rresht.
 - d. Nuk marrin pjesë në trajnimet ose nuk kalojnë testimet e organizuara nga KQZ.
 - e. Kur ata shkarkohen, nuk mund të rizgjidhen më në këtë detyrë.
2. Lirimi nga detyra ndodh kur anëtari i KQV është në kushte të konfliktit të interesit(krushqie apo marrëdhënie pune) me kandidatin.

3. Anëtari i KQV që dorëhiqet kryen këto veprime:
 - a. Depoziton deklaratën e dorëheqjes në KQV
 - b. Anëtari i KQV-së i liruar apo i dorëhequr, nuk largohet nga detyra, pa e dorëzuar atë tek zëvendësuesi i tij.
 - c. Sekretari njofton menjëherë KZAZ.

Kuorumi për veprimtarinë e KQV-së është 4 anëtarë. Në rast të mungesës së kuorunit, 24 orë para hapjes së procesit të votimit ose në ditën e zgjedhjeve, KQV vazhdon procedurat pavarësisht se është pa kuorumin e nevojshëm, por vetëm pas urdhërimit të KZAZ.

Sekretari dokumenton, regjistron dhe shënon në librin e protokollit të mbledhjeve të gjitha detajet e njoftimit të vakancës nga KQV dhe orën e komunikimit të urdhërimit të KZAZ për vijimin e procedurave, pavarësisht kuorunit.

V. Detyrat e KQV

Detyrat e kryetarit dhe të sekretarit të KQV janë të përcaktuara në nenin 36 të Kodit Zgjedhor si dhe në vendimin nr.11, datë 25.03.2021 të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, i ndryshuar.

Kryetari i KQV drejton veprimtarinë e KQV që nga dita e ngritjes së saj. Ai ka detyrimin të angazhohet në marrjen e materialeve zgjedhore dhe teknologjisë përkatëse, për fillimin e procesit të votimit në QV-it, ndjekjen e ecurisë së procesit të votimit me identifikimin e zgjedhësve, listën e zgjedhësve, vulosjen e fletës së votimit me Vulën e Kryetarit të QV, mbylljen e procesit të votimit si dhe drejton mbledhjet e KQV. Pra, në tërësi është përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në QV. Detyrat e sekretarit të KQV janë të përcaktuara në nenin 41 të Kodit Zgjedhor. Në tërësi, detyra e tij lidhet me administrimin e gjithë dokumentacionit ligjor ku bazohet puna e KQV. Puna e tij konsiston në marrjen e materialeve zgjedhore së bashku me kryetarin e KQV, administrimin e vulës së QV, vulosjen e fletëve të votimit me vulën e QV dhe procesverbaleve e vendimeve të KQV. Ai përgjigjet për vendosjen e materialeve zgjedhore në kutinë e materialeve të votimit dhe vulosjen e saj me vulat me kodet e sigurisë. Sekretari administron Librin e Protokollit të Mbledhjeve si dhe regjistron marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KZAZ, vendimet e KQV, vërejtjet e vëzhguesve. Edhe regjistri i posaçëm administrohet prej tij. Ai mban kontakte me KZAZ, me KQZ dhe me operatorin e pajisjes PEI dhe të kameras.

Anëtari i KQV është përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në QV duke zbatuar detyrat e përcaktuara me Vendim të KQV në funksion të mbarëvajtjes së zgjedhjeve në QV.

VI. Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së

1. Mbledhjet e KQV-së janë publike.
2. Vendimet e KQV-së merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Të vlefshme janë edhe vendimet e KQV-së, që kryen detyrat nën kuorum, por vetëm pas urdhërimit nga KZAZ. Anëtarët që kanë marrë pjesë në votim nënshkruajnë vendimet dhe deklarojnë votën “pro” apo “kundër”. Anëtari që ka deklaruar votën “kundër” ka mundësi të shprehë arsyetimin e tij për qëndrimin e tij.
3. KQV-ja gjatë punës së saj merr vendime të ndryshme si psh vendimin për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV-së, vendimin për hapjen e votimit, largimin e personave të caktuar nga mjediset e qendrës së votimit, pezullimin e votimit, kërkimin e ndihmës nga policia e shtetit apo largimin e policisë së shtetit nga qendra e votimit. Gjithashtu KQV merr vendim edhe për mbylljen e votimit. Një vendim tjetër është ai për përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar në qendrën e votimit në rast kundërshtimi. Për marrjen e vendimeve KQV përdor modelet e vendimeve dhe dokumentacionin e punës të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Të gjitha vendimet regjistrohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.
4. Në rastet se KQV nuk arrin të marrë vendim, çështja i dërgohet menjëherë për shqyrtim KZAZ-së nga kryetari ose nga të paktën dy anëtarë të KQV-së. Vendimi i KZAZ-së zbatohet nga KQV-ja.
5. KQV merr vetë vendimin për të vijuar votimin pa identifikim elektronik në rast se pajisja PEI nuk është riparuar apo zëvendësuar. Ky vendim merret vetëm pasi kalojnë 3 orë nga koha e njoftimit të asistencës teknike.

VII. Dokumentacioni i KQV-së dhe vulat

KQV-ja ka në dispozicion modelet e dokumentacionit të miratuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në dokumentacionin e punës të KQV-së përfshihen modelet e vendimeve dhe të procesverbaleve të cilat janë të emërtuara dhe pas vendimmarrjes së KQV-së plotësohen nga sekretari dhe nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KQV. Ky dokumentacion administrohet nga sekretari i KQV-së.

1. KQV ka në dispozicion edhe Librin e Protokollit të Mbledhjeve, në të cilin sekretari shënon të gjithë veprimtarinë e KQV-së, komunikimet e korrespondencat me KZAZ, incidentet, ankimmimet e vëzhguesve. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së ndodhen modelet e vendimeve dhe procesverbaleve të KQV-së, si dhe deklarata e personit që ndihmon një zgjedhës për të votuar.
2. Regjistri i posaçëm i zgjedhësve është dokumenti tjetër i punës i KQV-ës. Në regjistrin e posaçëm të zgjedhësve shënohen:

- Zgjedhësi i cili ka fituar të drejtë e votimit me vendimin e gjykatës. Vendimi origjinal i gjykatës administrohet nga sekretari, pasi ky vendim është marrë nga gjykata vetëm për votimin e zgjedhësit në qendrën e votimit që është përcaktuar në të.
 - Anëtarët e KQV-ës që nuk e kanë emrin në listën e zgjedhësve të QV.
 - Anëtarët dhe Sekretari i KZAZ, të pajisur me vërtetim të posaçëm të lëshuar nga Sekretari i KZAZ, ku përcaktohet QV ku do të votojë secili prej tyre.
 - Operatori teknik i QV/personi i ngarkuar me detyrë për funksionimin e kameras.
3. Sa i përket modeleve të procesverbaleve sqarojmë se procesverbali për vulosjen e kutive të votimit plotësohet para fillimit të votimit. Origjinali i këtij procesverbali futet në kutinë e votimit për kryetar të bashkisë, para fillimit të procesit të votimit, ndërsa nga një kopje e tij futen përkatësisht një kopje në kutinë e votimit të këshillit të bashkisë para fillimit të procesit të votimit dhe një në kutinë e materialeve të votimit.
- Procesverbali i mbylljes së votimit plotësohet pasi merret vendimi për mbylljen e votimit dhe ka pasi votuar edhe zgjedhësi i fundit në radhë. Ky procesverbal futet në kutinë e votimit për kryetar të bashkisë, pasi është futur më parë në zarfin përkatës të procesverbalit të mbylljes së votimit. Është shumë e rëndësishme që KQV të dijë rëndësinë e plotësimit të të dhënave të sakta në këtë procesverbal. Plotësimi i saktë i të dhënave, futja e origjinalit në kutinë e votimit për kryetar të bashkisë si dhe futja e kopjeve përkatësisht në kutinë e votimit për këshill të bashkisë dhe në atë të materialeve të votimit janë hapa të rëndësishëm dhe që ndikojnë në vijimin e rregullt të procesit të numërimit të votave.
4. KQV plotëson edhe procesverbalin e pezullimit të votimit kur në QV është rrezikuar rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit. Në situata të tilla, KQV kërkon ndihmën e policisë së Shtetit. Për të thirrur policinë e Shtetit, KQV merr vendim për kërkimin e ndihmës së policisë së Shtetit. Gjithashtu, policia e Shtetit largohet nga QV, pasi ka vendosur rendin në të. KQV, edhe në këtë rast, duhet të plotësojë vendimin për largimin e policisë së Shtetit nga QV si dhe duhet të plotësojë procesverbalin për rifillimin e votimit.
5. KQV është pajisur nga KZAZ edhe me vulën e KQV me tekstin “KOMISIONI I QENDRËS SË VOTIMIT” dhe numrin e qendrës përkatëse të votimit përdoret dhe administrohet nga sekretari. Me të vuloset pjesa e pasme e fletës së votimit dhe të gjitha vendimet e procesverbalet e KQV-së.
- Ndërsa vula e kryetarit me tekstin “KRYETARI” dhe një numër serial përdoret vetëm për vulosjen e fletëve të votimit dhe për asnjë dokument tjetër zgjedhor.
6. Në rastet e dëmtimit, humbjes apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës, KQV pajiset me vulë rezervë. Rastet e problematikave me vulën i njoftohen menjëherë KZAZ. Dëmtimi i qëllimshëm ose nxjerrja e vulës jashtë qendrës së votimit përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 326/a të Kodit Penal. Nxjerrja jashtë përdorimit e vulës bëhet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa dorëzimi i vulës rezervë bëhet me procesverbalin përkatës.
7. Gjithashtu, KQV plotëson edhe një procesverbal të mbylljes së QV me etiketën e sigurisë, një ditë para ditës së zgjedhjeve. Ky është një procesverbal që mbahet në prani të punonjësit të

policisë dhe në këtë procesverbal shënohet kodi përkatës me të cilin është mbyllur qendra e votimit. Kopje e këtij procesverbali i jepjet punonjësit të policisë. Edhe marrja në dorëzim e QV nga KQV, në ditën e zgjedhjeve, dokumentohet nga procesverbali për hapjen e QV së votimit në ditën e zgjedhjeve, përmes të cilit, evidentohet kodi me numrin serial i cili duhet të jetë ai me të cilin është u mbyll QV, një ditë para zgjedhjeve.

Shtojca 2

1. Aplikacioni KQZ, përdorimi dhe raportimi

Çdo anëtar i KQV përfshirë edhe sekretarin krijon llogarinë e tij në këtë aplikacion.


A. KRIJIMI I LLOGARISË

Llogaria krijohet nëpërmjet kësaj procedure:


- 1) Hyr në aplikacionin KQZ në telefonin celular, ose në tableta;
- 2) Kliko në fund të ekranit të telefonit, djathtas ku është butoni “Komisioner” (shiko figurën 1.1).



- 3) Në ekran shfaqet pamja (si në figurën 1.2 më poshtë)



- 4) Shtyp butonin “Regjistrohu”; (si ne figurën 1.3)



- 5) Në ekran shfaqet pamja (si në fig. 2)




Figura 2

- 6) Vendosi numrin tuaj personal sipas kartës se identitetit dhe numrin tuaj te telefonit (si në figurën 3)



Figura 3

- 7) Sigurohu që keni vendosur të dhënat e sakta dhe kliko “Regjistrohu” (shih Figura 4)



Figura 4

8. Pas klikimit, të dhënat tuaja janë dërguar në sistemin e bazës së të dhënave në KQZ ku bëhet verifikimi automatik i tyre. Nëse ju jeni anëtar, apo sekretar i KZAZ, apo KQV, sistemi krijon llogarinë tuaj dhe ju dërgon në telefon një SMS e cila përmban fjalëkalimin për të hyrë në llogarinë tuaj (siç tregohet në figurën 5).




Figura 5


9. Në aparatin tuaj të telefonit ju do të njoftoheni me një mesazh për regjistrimin në aplikacionin KQZ (si në figurën 6)



10. Mbani shënim fjalëkalimin i cili ju nevojitet për të hyrë në sistem.

B. HYRJA NË LLOGARI


1. Pasi ke hyrë në aplikacionin KQZ, kliko në fund të ekranit të telefonit, djathtas ku është butoni “Komisioner” (shiko figurën 7).



2. Në ekran shfaqet pamja (si në figurën 8)




3. Vendos numrin personal të Identifikimit në fushën përkatëse si në figurën 9.




4. Vendos fjalëkalimin që është dërguar me SMS si në figurën 10




5. Shtyp butonin HYR (shiko figurën 11)



6. Pasi keni shtypur HYR do ju shfaqet ne ekran kjo dritare me kete permbajtje (duke specifikuar emrin, pozicionin, daten e oren) si në figurën 12



7. Në rastin kur duhet të raportosh kliko (shtyp) butonin “Raporto” si në figurën 13



8. Ditën e votimit Sekretari do të plotësojë pyetësonin duke zgjedhur njërën prej opsioneve të kërkuara

I. Përpara Ditës së Votimit

A. Përgjigju pyetjeve

1. A keni marrë nga KZAZ kutinë e ambalazhit të materialeve zgjedhore (kutia e mbyllur në të cilën ndodhen materialet e votimit)?

- Po Jo

2. A keni marrë nga KZAZ pajisjen elektronike të identifikimit (PEI)?

- Po Jo

3. A keni marrë nga KZAZ kamerën dhe aksesoret që do të vendosen në qendrën tuaj të votimit?

- Po Jo

4. A janë trajnuar të gjithë anëtarët KQV për procedurat e ditës së votimit?

- Po Jo

5. A është qendra juaj e votimit e sigurt dhe e përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve ?

- Po Jo

B. Ngarko Dokumente

1. Foto grafo Procesverbalin KQZ-00-04

2. Foto grafo Procesverbalin: KQZ-00-05

3. Foto grafo Procesverbalin: KQZ-00-06

4. Foto grafo Procesverbalin: KQZ-00-11

C. Informo më Shumë (Free text)

II. Në Ditën e Votimit

A. Përgjigju pyetjeve

1) A janë të pranishëm në QV më shumë se 4 anëtarë? - Po Jo

2) A është prezent në QV operatori i PEI? - Po Jo

3) A e instaluat kamerën e vëzhgimit në QV sipas udhëzimeve të KQZ? - Po Jo

- 4) A ka mungesa të bazës materiale zgjedhore? - Po Jo
(nëse PO shëno çfarë mungon – free text).
- 5) A i keni vendosur në ambientin e QV dhe jashtë saj posterat dhe shenjat e tjera dalluese sipas udhëzimeve të KQZ? - Po Jo
- 6) Shëno orën kur filloi procesi i votimit [-].
- 7) A ka vëzhgues në QV në momentin e hapjes së votimit? - Po Jo
- 8) A po kryhet identifikimi i zgjedhësve nëpërmjet PEI? - Po Jo (periodike)
- 9) Procesi i votimit është: - Normal; - Me probleme; - I bllokuar (periodike)
- 10) A ka persona të paautorizuar në QV? - Po Jo (periodike)
- 11) A e keni njoftuar policinë kur është rasti? - Po Jo (periodike)
- 12) A ka vëzhgues të cilët shënojnë numrat/emrat e zgjedhësve që votojnë? - Po Jo (periodike)

B. Ngarko Dokumente

- 1) Foto grafo KQZ-01-26
- 2) Foto grafo KQZ-01-27
- 3) Foto grafo KQZ-01-28
- 4) Foto grafo KQZ-01-29
- 5) Foto grafo KQZ-00-12
- 6) Foto grafo KQZ-00-13
- 7) Foto grafo shënime t për parregullsi në KQZ-02-07

C. Informo më Shumë (Free text)

III. Mbyllja e Votimit

A. Përgjigju pyetjeve

1. A mori vendim KQV për mbylljen e votimit?
- Po Jo
2. Shëno orën e mbylljes së votimit: _____
3. Shkruaj numrin e zgjedhësve që kanë votuar: ____
4. Zgjidh si u zhvillua procesi i identifikimit:
 - a. Identifikimi i zgjedhësve u krye tërësisht elektronikisht (me PEI).
 - b. Identifikimi i zgjedhësve filloi me PEI dhe përfundoi me listën fizike të zgjedhësve
 - c. Identifikimi i zgjedhësve filloi me listën fizike të zgjedhësve dhe përfundoi me PEI
 - d. Identifikimi i zgjedhësve u krye tërësisht me listën fizike të zgjedhësve

B. Ngarko Dokumente


1. Foto grafo KQZ-00-08
2. Foto grafo KQZ-00-09
3. Foto grafo raportin e mbylljes PEI

C. Informo më Shumë (Free text)

9. Pasi keni plotësuar njëren prej pyetjeve apo të gjitha pyetjet shtyp butonin “Dërgo raportimin” si në figurën 15



11. Në rastin kur Sekretari do të ngarkojë dokument (foto vendimi/ procesverbali hapje/ mbyllje) kliko butonin “Ngarko Dokumentacion” si në figurën 17



12. Nëpërmjet kamerës së aparatit do të ngarkoni fotografinë dhe do të dërgoni raportimin tuaj.

13. Kryetar, Sekretar dhe çdo anëtar, KUJTO Operatorin e PEI që të skanojë çdo orë Kodin QR që printon pajisja PEI për raportimin e pjesëmarrjes.

14. Çdo anëtar i KQV-së mund të denoncojë shkelje të ligjit nga subjektet, anëtarët e tjerë të komisionit apo nga zgjedhësit nëpërmjet këtij aplikacioni.

Shtojca 3

I. PLOTËSIMI I PROCESVERBALIT TË MBYLLJES SË VOTIMIT

Plotësimi i saktë i procesverbalit të mbylljes së votimit është shumë i rëndësishëm. Ai njihet ndryshe edhe si procesverbali KQZ 08.

Në këtë procesverbal Sekretari i KQV duhet të plotësojë me radhë rubrikat e kërkuara. Të dhënat që duhet të plotësohen kanë të bëjnë me:

- numrin e zgjedhësve të identifikuar elektronikisht
 - numrin e zgjedhësve të identifikuar elektronikisht të ndarë sipas gjinisë;
 - numrin e zgjedhësve të identifikuar elektronikisht pa gjurmë të gishtërinjve
 - numrin e rasteve të veçanta të identifikimit të zgjedhësve (zgjedhës me vendim gjyqate, administratë zgjedhore);

Koha kur plotësohet procesverbali i mbylljes së votimit

Procesverbali për mbylljen e votimit plotësohet pasi KQV merr vendim për mbylljen e votimit duke urdhëruar operatorin teknik të mbyllë identifikimin elektronik të zgjedhësve. Menjëherë pasi Operatori Teknik i QV ka mbyllur procesin e identifikimit elektronik të zgjedhësve në QV, pajisja PEI prodhon raportin e mbylljes.

Ky raport përmban të dhëna, disa prej të cilave i nevojiten KQV për plotësimin e Procesverbalit Model KQZ-00-08.

Situata 1

Në rastin kur procesi i votimit është kryer tërësisht përmes identifikimit elektronik të pajisjes PEI, KQV plotëson rubrikat e procesverbalit si vijon:

1. Numri i zgjedhësve që kanë votuar. Ky numër gjendet në raportin e mbylljes së printuar nga pajisja PEI.
2. Numri i zgjedhësve gra merret nga Raporti i Mbylljes i prodhuar nga pajisja PEI.
3. Numri i Plotë i fletëve të votimit të QV të marra ne dorëzim. KQV këtë shifër e merr nga Procesverbali Model KQZ-00-05
4. Numri i fletëve të votimit të papërdorura
Kjo shifër del nga numërimi fizik që kryhet për fletët që KQV nuk i ka përdorur. Kryetari KQV, deklaron me zë të lartë shifrën. Ky numër shënohet në këtë procesverbal dhe në LPM
5. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara
Kjo shifër del nga numërimi fizik që kryhet për fletët që KQV i ka vlerësuar të dëmtuara. Kryetari KQV, deklaron me zë të lartë shifrën. Ky numër shënohet në këtë procesverbal dhe në LPM

Situata 2

Në rastin kur procesi i votimit është kryer tërësisht përmes identifikimit elektronik të pajisjes PEI, KQV plotëson rubrikat e procesverbalit si vijon

1. Numri i zgjedhësve që kanë votuar.

- a. KQV numëron fillimisht vërtetimet të identifikimit elektronik të zgjedhësve të administruara nga kryetari i KQV. Shifra mbahet shënim në një fletë të zakonshme.
 - b. Më pas KQV, në listën e zgjedhësve, numëron nënshkrimet e zgjedhësve dhe shifrën e mban shënim në fletën e zakonshme.
 - c. Mblidhen të dy shifrat.
2. Numri i zgjedhësve gra merret nga sërish nga vërtetimet e identifikimit elektronik të zgjedhësve si dhe nga lista e zgjedhësve të nënshkruar prej tyre.
 3. Numri i Plotë i fletëve të votimit të QV të marra ne dorëzim. KQV këtë shifër e merr nga Procesverbali Model KQZ-00-05
 4. Numri i fletëve të votimit të papërdorura
Kjo shifër del nga numërimi fizik që kryhet për fletët që KQV nuk i ka përdorur. Kryetari KQV, deklaron me zë të lartë shifrën. Ky numër shënohet në këtë procesverbal dhe në LPM
 5. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara
Kjo shifër del nga numërimi fizik që kryhet për fletët që KQV i ka vlerësuar të dëmtuara. Kryetari KQV, deklaron me zë të lartë shifrën. Ky numër shënohet në këtë procesverbal dhe në LPM

Situata 3

Në rastin kur procesi i votimit është kryer tërësisht pa identifikim elektronik dhe procesi i votimit nga momenti i fillimit dhe deri në mbyllje të tij është realizuar përmes identifikimit me listën e zgjedhësve. KQV plotëson rubrikat e procesverbali si vijon:

1. Numri i zgjedhësve që kanë votuar. Ky numër gjendet nga numërimi i nënshkrimeve në listën e zgjedhësve si dhe nga numërimi i nënshkrimeve në regjistrin e posacëm.
2. Numri i zgjedhësve gra merret nga numërimi i nënshkrimeve gra në listën e zgjedhësve si dhe nga numërimi i nënshkrimeve gra në regjistrin e posacëm .
3. Numri i Plotë i fletëve të votimit të QV të marra ne dorëzim. KQV këtë shifër e merr nga Procesverbali Model KQZ-00-05
4. Numri i fletëve të votimit të papërdorura. Kjo shifër del nga numërimi fizik që kryhet për fletët që KQV nuk i ka përdorur. Kryetari KQV, deklaron me zë të lartë shifrën. Ky numër shënohet në këtë procesverbal dhe në LPM
5. Numri i fletëve të votimit të dëmtuara
Kjo shifër del nga numërimi fizik që kryhet për fletët që KQV i ka vlerësuar të dëmtuara. Kryetari KQV, deklaron me zë të lartë shifrën. Ky numër shënohet në këtë procesverbal dhe në LPM

Gjithashtu, KQV plotëson në këtë procesverbal edhe kodin e sigurisë së vulës së pestë me të cilën mbyllet kutia e votimit si dhe katër kodet e sigurisë me të cilat do të mbyllet kutia e materialeve zgjedhore.

Mbasi keni shënuar këto kode, futeni procesverbalin MODEL KQZ-00-08 në zarfin përkatës. Zarin me procesverbalin e mbylljes së votimit futeni në kutinë e votimit dhe pastaj mbylleni atë me kodin e pestë që keni selektuar. Një kopje e këtij procesverbali futet në kutinë e materialeve zgjedhore dhe një kopje dorëzohet dorazi në KZAZ.

II. Rregulla në qendrën e votimit

1. KQV lejon në qendrën e votimit:

a) vëzhgues të cilët duhet të jenë domosdoshmërisht të akredituar nga KQZ apo KZAZ. Komisioni i qendrës së votimit nuk duhet të lejojë që në qendrën e tij të jenë të pranishëm në të njëjtën kohë më shumë se: Një vëzhgues i partive politike që nuk janë pjesë e koalicioneve, i kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit dhe i organizatave jo-fitimprurëse shqiptare; Dy vëzhgues të organizatave jo-fitimprurëse të huaja apo ato ndërkombëtare; Tre vëzhgues nga çdo koalicion. Kandidatët e partive politike nuk kanë të drejtë të caktojnë vëzhgues. Vëzhguesi/vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, të akredituar në KZAZ, mund të vëzhgojnë procesin zgjedhor dhe në Qendrat e Votimit të kësaj Zone të Administrimit Zgjedhor.

Sekretari i KQV-së u kontrollon vëzhguesve shqiptarë dhe të huaj dokumentin e akreditimit dhe dokumentin e identifikimit të vlefshëm. Komisioni i Qendrës së Votimit duhet t'u mundësojë vëzhguesve vëzhgimin pa pengesë të procesit zgjedhor në të gjitha fazat, kqyrjen e dokumentacionit e të materialeve zgjedhore dhe t'u pranojnë atyre vërejtjet me shkrim për çdo lloj parregullsie që vërehet. Gjithashtu KQV duhet të kujdesen që vëzhguesit të mos bëjnë propagandë e të mos influencojnë në vullnetin e zgjedhësit si dhe të mos ndërhyjnë në procesin e votimit dhe të vendimmarrjes së KQV.

b) operatorin teknik të QV-së i emëruar nga KQZ/personin e ngarkuar me detyrë për funksionimin e kamerës në QV.

c) zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit.

KQV, vëzhguesit, operatori apo personeli teknik i asistencës së pajisjes PEI duhet të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentin e identifikimit sipas funksionit që ata kanë të lëshuar nga KQZ/KZAZ dhe të kenë letërnjoftimin/kartën e identitetit ose pasaportën. Këto dokumente i verifikon sekretari i KQV.

2. KQV, lejon, me vendim të tij, hyrjen e largimin e personelit teknik të njoftuar për dhënien e asistencës teknike në rastin kur PEI ose kamera ka probleme të funksionimit si dhe të punonjësit të Policisë së Shtetit, kur janë duke ushtruar detyrën për rivendosjen e rendit të QV. Ndërhyrja e Policisë së Shtetit dokumentohet në detaje nga KQV.

3. Fotografimi i votës, është rreptësisht i ndaluar. KQV nuk lejon përdorimin e telefonave celularë dhe kamerave të çdo lloji nga askush me përjashtim të:

a) Përdorimit të telefonit celular nga sekretari për komunikimet me KZAZ për hapjen e mbylljen e procesit të votimit si dhe për pjesëmarrjen në votim.

b) Filmimeve të shkurtra jo më shumë se 15 minuta të procesit zgjedhor nga ana e vëzhguesve të medias së akredituar, por pa penguar procesin e votimit dhe pa kompromentuar fshehtësinë e votimit.

4. Në Librin e Protokollit të Mbledhjeve shënohet çdo largim i anëtarit të KQV apo i sekretarit. Kur kryetari apo sekretari largohet, çdo material dhe detyrë e tyre i delegohet një anëtarit me të njëjtën përkatësi politike.

III. Raste të veçanta votimi

1. Zgjedhësi që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit. Ky zgjedhës, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër. Të dy zgjedhësit duhet të jenë në listën e zgjedhësve të asaj QV-je dhe të pranishëm në qendrën e votimit. Verifikimin në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit e bën Kryetari i KQV-së. Zgjedhësi që kërkon ndihmë për të votuar kryen identifikimin elektronik, ndërsa personi që do ta ndihmojë, para se të shënojë në fletën e votimit, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, në modelin përkatës. Anëtarët e KQV apo operatori nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë. Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë. Zgjedhësi i shoqëruar nga personi që do ta ndihmojë hyjnë në dhomën e fshehtë. Sekretari i KQV regjistron dhe dokumenton rastet e zgjedhësve që për arsye fizike nuk mund të votojnë vetë.
2. Zgjedhësi që nuk shikon por që mund të votojë vetë. Këtij zgjedhësi i mundësohet votimi duke përdorur shabllonin/maskën me alfabetin braille. Fleta e votimit futet plotësisht brenda shabllonit maskës me alfabetin braille, në mënyrë të tillë që çdo kuadrat për shënimin e zgjedhësit të përputhet me çdo kuadrat të maskës me alfabetin braille.
3. Në një qendër votimi, KQV lejon operatorin teknik të vijojë me identifikimin e zgjedhësit për:
 - a) Zgjedhësin që paraqitet për të votuar me vendim gjykate, përmes të cilit zgjedhësit i jepet e drejta të votojë në atë qendër votimi. Emri dhe mbiemri i zgjedhësit, që paraqitet për të votuar me vendim gjykate, si dhe numri i dokumentit të identifikimit shënohet nga KQV-ja në regjistrin e posaçëm, të cilit i bashkëngjitet vendimi i gjykatës. KQV lejon operatorin teknik të kryejë identifikimin elektronik të zgjedhësit.
 - b) Anëtarët e KQV-së
 - c) Anëtarin e KZAZ i pajisur me vërtetimin e posaçëm, lëshuar nga sekretari i KZAZ.
 - d) Operatorin teknik i QV/ personin e ngarkuar me detyrë për funksionimin e kamerës në rast se nuk janë zgjedhës në atë qendër votimi dhe është zgjedhës i zonës zgjedhore.Sekretari i KQV mban shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve rastet kur ka lejuar identifikimin elektronik të zgjedhësve të përmendur në këtë pikë.
4. Zgjedhësi, dokumenti i identitetit të të cilit është i dëmtuar dhe nuk lexohet nga PEI. Operatori teknik shtyp në mënyrë manuale të dhënat e zgjedhësit në ekranin PEI.
5. Zgjedhësi që kryen identifikimin elektronik pa depozituar gjurmë të gishtërinjve. Zgjedhësi nënshkruan në listën e zgjedhësve dhe në dokumentin fizik të printuar nga pajisja PEI, që evidenton se gjurmët e gishtërinjve nuk u depozituan. Më pas atij i dorëzohet fleta e votimit. Zgjedhësit nuk i dorëzohet fleta e votimit nëse ai nuk nënshkruan në listën e zgjedhësve. Sekretari i QV i pasqyron këto fakte në librin e protokollit të mbledhjeve duke shënuar orën,

identitetin e tij me shënimin “zgjedhësi u identifikua me nënshkrim, pa gjurmë gishtërinjsh” si dhe rastet e mosnënshkrimit të dokumentit të printuar nga PEI.

6. Zgjedhësi që nuk pranon të timbroset me lëndën e posaçme. KQV nuk e pajis këtë zgjedhës me fletët e votimit dhe identiteti i tij mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve.

IV. Veprimet që çënojnë procesin e votimit

Më poshtë janë renditur disa raste që në ditën e votimit, mund të çënojnë rregullshmërinë e procesit të votimit dhe për të cilat KQV duhet të jetë e qartë, për rregullat që duhet të ndiqen në raste të tilla.

- a) Zgjedhësi në tentativë për votim për herë të dytë

Në rastin kur zgjedhësi që ka votuar më parë në atë QV, duke u identifikuar përmes PEI-t, tenton të kryejë sërish identifikimin elektronik:

- i KQV sinjalizohet përmes një tingulli të posaçëm dhe ngjyrës së kuqe që shfaqet në ekranin e PEI;
- ii PEI printon menjëherë vërtetimin me emrin, mbiemrin, numrin personal, datën e lindjes, dhe fotografinë e personit, orën kur ky person ka votuar në QV, me tekstin “tentativë për votim të dyfishtë”.

“Sekretari i KQV-së regjistron të dhënat e zgjedhësit në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së, dhe pasi verifikon informacionin me dokumentin e printuar nga PEI dhënë nga Operatori teknik/personi i autorizuar nga KQZ, e përcjell tek Kryetari i KQV-së. Dokumenti fizik administrohet nga Kryetari i KQV-së në zarfin ku shënohet “*vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësve*”.

- b) Zgjedhësi që paraqitet në qendrën e votimit ku nuk është i regjistruar.

Në rastin kur zgjedhësi nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të QV-së:

- i KQV sinjalizohet përmes një tingulli dhe ngjyrës së verdhë që shfaqet në ekranin e PEI. Në ekran shfaqet numri i QV ku zgjedhësi është i regjistruar;
- ii PEI printon raportin me datën, orën, dhe numrin e QV-së ku zgjedhësi është i regjistruar, i cili i dorëzohet zgjedhësit për orientim. Ky është i vetmi rast kur zgjedhësit i jepet dokumenti i printuar.

Sekretari i KQV-së regjistron të dhënat e zgjedhësit në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së.

- c) Zgjedhësi voton jashtë dhomës së fshehtë, dëmton fletën e votimit pa dashje apo fotografon fletën e votimit në dhomën e fshehtësisë. Në të gjitha këto raste:

- i. Fletët e votimit konsiderohen të dëmtuara dhe në pjesën e pasme të fletës së votimit kryetari shënon “e dëmtuar”. Ato nuk hidhen në kutinë e votimit, por administrohen në zarfin e fletëve të votimit të dëmtuara dhe zgjedhësit i jepet një fletë e re.

- ii. Nëse i njëjti veprim përsëritet nga zgjedhësi, fletët e votimit konsiderohen të dëmtuara dhe nuk hidhen në kutinë e votimit, por administrohen në zarfin e fletëve të votimit të dëmtuara dhe zgjedhësit nuk i jepet një fletë e re.
- d) Votimi familjar dhe në emër të të tjerëve është i paligjshëm, apo prezenca e individëve me armë, përdorimi i celularëve apo pirja e duhanit.
- e) Grumbullimi i personave në mjediset jashtë qendrës së votimit në një rreze prej 150 m, në oborr apo në korridoret e brendshme. Krijimi i situatave të tilla është shkak për pezullimin e procesit dhe kërkimin e ndërhyrjes së policisë. Bëjnë përjashtim këtu, zgjedhësit, vëzhguesit, media e autorizuar apo personat e ngarkuar për sondazhe nga OJF të autorizuar nga KQZ, për këtë qëllim.